



## PSSA: Sistemi i Vlerësimit Shkollor i Pensilvanisë

---

### Çfarë është PSSA?

Sistemi i Vlerësimit Shkollor i Pensilvanisë (Pennsylvania System of School Assessment, PSSA) është një vlerësim i bazuar në standarde, i cili u jep studentëve, prindërve, mësuesve dhe qytetarëve njohuri për performancën e studentit dhe të shkollës lidhur me përvetësimin e standardeve akademike. Këto standarde në Artet e Gjuhës Angleze, Matematikë dhe Shkencë tregojnë se çfarë duhet të dijë dhe çfarë duhet të jetë i aftë të bëjë një student në nivele të ndryshme klase. Studentët e Pensilvanisë të klasave 3 deri në 8 vlerësohen në Artet e Gjuhës Angleze dhe Matematikë, dhe studentët e Pensilvanisë të klasave 4 dhe 8 vlerësohen në Shkencë.

### Kur do të marrë pjesë në PSSA fëmija im?

PSSA zhvillohet çdo vit, dhe periudhat e testimit zakonisht janë në prill dhe maj. Kalendarin për periudhat e testimit PSSA mund të gjendet [këtu](#). Duhet të shikoni [Kalendarin e SDP për Vlerësimet](#) si edhe kalendarin e shkollës të fëmijës suaj për datat specifike se kur do të zhvillohet PSSA në shkollën e tij ose të saj.

### Çfarë bëjnë mësuesit me rezultatet e PSSA të fëmijës tim?

Rezultatet individuale të studentëve, të cilat i jepen vetëm shkollës të fëmijës tuaj, mund të përdoren për të ndihmuar mësuesit të dallojnë cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të fëmijës suaj. Kjo më pas u jep mundësi mësuesve ta përshtatin mësimdhënien për fëmijën tuaj në mënyrë që ta ndihmojnë të zhvillohet më tej. Rezultatet e PSSA u sigurojnë gjithashtu informacion shkollave dhe qarqeve, i cili mund të ndihmojë në përmirësimin dhe planifikimin e diskutimeve për planin mësimor dhe mësimdhënien.

### Çfarë lloj pyetjesh bëhen në PSSA?

Për PSSA të ELA, shumica e pikave të testit janë pyetje me alternativa. Megjithatë, ka edhe një komponent me shkrim për të gjitha nivelet e klasave. Studentëve të klasës së tretë u kërkohet t'u përgjigjen tre pyetjeve me përgjigje të shkurtër, ndërsa studentëve të klasave 4 deri në 8 u kërkohet t'u përgjigjen dy pyetjeve për Analizë të Pavarur të Tekstit. Përgjigjet e shkurtra dhe përgjigjet e Analizës së Pavarur të Tekstit vlerësohen duke përdorur një rubrikë.

Për PSSA-të e Matematikës dhe Shkencës, të gjithë studentëve, pavarësisht nga niveli i klasës, u bëhen një kombinim pyetjesh me alternativa dhe pyetjesh të hapura-të mbyllura. Përgjigjet e hapura vlerësohen duke përdorur një rubrikë.

Për më shumë informacion lidhur me këtë temë, ju lutemi të shikoni dokumentet e projektimit të testit të [Matematikës](#), [ELA](#) dhe [Shkencës](#).

## Cilat lloje rezultatesh raportohen në PSSA?

Për të tria lëndët e testuara, studentët marrin një rezultat të përgjithshëm, një rezultat shkalle dhe një vlerësim performance (Nën bazë, Bazë, I aftë, ose I avancuar) i cili lidhet me një rreze specifike të rezulttit të shkallës. Rezultati i shkallës i lidhur me secilin grup performance ndryshon në varësi të nivelit të klasës dhe lëndës. Për një ndarje më të hollësishme, mund të shikoni [Dokumentin për rreziqet e rezulttit të shkallës](#) të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë.

Përveç kësaj, Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë u jep shkollave raporte për performancën individuale të studentëve nëpërmjet Kategorisë së Raportimit dhe Spirancës së Vlerësimit. Spirancat e Vlerësimit përfaqësojnë kategoritë e lëndëve (aftësitë dhe konceptet) që ankorojnë përmbajtjen e PSSA.

Për PSSA të ELA, ka katër Spiranca Vlerësimi, të cilat janë të njëjta në klasat 3-8. Idetë kryesore & Detajet, Zanati & Struktura, Fjalori dhe Gjuha. Klasat 4-8 kanë një Spirancë Vlerësimi shtesë: Analiza e Pavarur e Tekstit.

PSSA të Matematikës, Spirancat e Vlerësimit ndryshojnë sipas klasave. Për klasat 3-5, Spirancat e Vlerësimit janë: Numrat dhe Operacionet në Dhjetëshen Bazë, Thyestat, Operacionet & Të Menduarit Algjebrik, Gjeometri, Matje & Të dhëna. Për klasat 6-7, Spirancat e Vlerësimit janë: Sistemi i numrave, Raportet & Marrëdhëniet Proporcionale, Shprehjet & Ekuacionet, Gjeometria, si dhe Statistikat dhe Probabiliteti. Për klasën e 8-të, Spirancat e Vlerësimit janë: Sistemi i numrave, Funkcionet, Shprehjet & Ekuacionet, Gjeometria, si dhe Statistikat dhe Probabiliteti.

### Çfarë do të thotë “Nën bazë”, “Bazë”, “I aftë” ose “I avancuar”?

Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë ka përshkruar të nivelit të performancës si për [Matematikën](#), ashtu edhe për [ELA](#) në faqen e tij të internetit.

Për PSSA të Shkencës, Spirancat e Vlerësimit janë të njëjta si për klasën e 4-rt, ashtu edhe për klasën e 8-të. Ka disa Spiranca Vlerësimi, të cilat mund të grupohen sipas Kategorive të Raportimit të mëposhtme: Natyra e Shkencës, Shkencat Biologjike, Shkencat Fizike, dhe Shkencat e Tokës & Hapësirës.

## A është PSSA me kohë?

PSSA nuk është me kohë, megjithatë studentët nuk mund ta plotësojnë një seksion në më shumë se një ditë. Nëse një student e fillon një seksion të hënën, ai nuk mund ta përfundojë atë seksion të martën. Për ELA, vlerësimi ndahet në tri seksione. Për Matematikën dhe Shkencën, vlerësimi ndahet në dy seksione. Koha e përlogaritur për të përfunduar një seksion të PSSA ndryshon në varësi të llojeve të pyetjeve që bëhen në secilin seksion të caktuar. Për më shumë informacion lidhur me këtë temë, duke përfshirë llojet e pyetjeve që bëhen në secilin seksion dhe kohën e përlogaritur për të përfunduar secilin seksion, ju lutemi të shikoni dokumentet e projektimit të testit të [Matematikës](#), [ELA](#) dhe [Shkencës](#).

## A ndikon PSSA te notat e fëmijës tim?

Ky test nuk ndikon te notat e studentëve.

## Si mund të marrë pjesë fëmija im në PSSA?

PSSA zakonisht bëhet me laps dhe letër; megjithatë ka edhe versione online të testit. Pavarësisht nga versioni që zgjedh fëmija juaj, të gjithë studentët duhet të jenë të pranishëm fizikisht në shkollë për PSSA.

## Ku mund t'i gjejë rezultatet nga PSSA?

Shkollat marrin dy kopje në letër të Raportit të Studentit në çdo periudhë vjeshte. Mund t'i kërkonti shkollës së fëmijës suaj një kopje të shtypur të Raportit të Studentit. Rezultatet postohen gjithashtu në një Portal për Prindërit te pjesa Testi Standard te Profili i Studentit.

## Kë mund të kontaktoj nëse kam pyetje të mëtejshme për PSSA?

Nëse keni pyetje të mëtejshme rreth PSSA, rekomandohet që të kontaktoni shkollën e fëmijës suaj. Informacionet e kontaktit për shkollën e fëmijës suaj mund të merren nga [faqja e internetit e Profileve të Shkollës](#) e SDP.

## Ku mund të gjej më shumë informacion për PSSA?

Zyra e Vlerësimeve e Rrethit Shkollor të Filadelfias: <https://www.philasd.org/era/assessment/>

Faqja e internetit e PSSA të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë: <https://www.education.pa.gov/K-12/Assessment%20and%20Accountability/PSSA/Pages/default.aspx>